



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:171412

Datë: 23.01.2023

Numri i dokumentit: 03901250

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.I avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, si dhe kompensimin e shpenzimit për shujtë ditore, me vlerë të kontestit 5,110.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik të datës 23.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.A nga fshati ..., Komuna e Gjilanit dhe detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, për vitet 2018, shumën e të hollave në lartësi prej 586.97€, për vitin 2019, shumën e të hollave në lartësi prej 836.71€, për vitin 2020, shumën e të hollave në lartësi prej 696.98€, për vitin 2021 shumën e të hollave në lartësi prej 696.06€ dhe për vitin 2022, shumën e të hollave në lartësi prej 846.03€, gjithsejt shumën prej 3,662.75 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 30.07.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për shujtë ditore, për periudhën kohore 15.11.2018-31.12.2022, për 1018 ditë pune, t'ia paguajë paditësit shumën prej 2,036.00 euro, e llogaritur nga 2.00 euro në ditë, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 30.07.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 299.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 30.07.2021 ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, si dhe kompensimin e shpenzimit për shujtë ditore. Në padi, paditësi ka theksuar se ka themeluar marrëdhënie pune me afat të pacaktuar, në orar të plotë të e paditura, në vendin e punës Polic Hetues në Stacionin Policor në Gjilan, ku vazhdon punën edhe sot, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018, të njëjtit i takojnë shpenzimet për shujtë ditore për ditët e pranisë në punë dhe shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, edhe atë që nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi e deri më datë 31.12.2022. Për realizimin e këtyre të drejtave ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo është refuzuar nën arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë, më datë 22.02.2022 ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, të cilin e paditura, së bashku me shkresat e lëndës e ka pranuar më datë 01.03.2022, sipas fletëkthesës që gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes. E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për shkak të kompetencës territoriale, mos shtjerrjes së mjeteve të brendshme të ankimimit, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare, që sipas të paditurës, nuk janë ndarë nga Ministria e Financave.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 23.01.2023, me propozimin e të autorizuarit të paditësit është mbajtur në mungesë të palës së paditur, pasi që e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, ku i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, t'ia paguajë paditësit shumën prej 3,662.75 euro dhe në emër të kompensimit për shujtë ditore, për periudhën kohore 15.11.2018-31.12.2022, për 1018 ditë pune, t'ia paguajë paditësit shumën prej 2,036.00 euro, e llogaritur nga 2.00 euro në ditë, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 30.07.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar, edhe atë 104.00 euro për përpilim të padisë, 60.00 euro për taksë gjyqësore dhe 135.00 euro për përfaqësim në një seancë.

Gjykata, për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Lista e pagave për vitet 2021 dhe 2022; Formulari i vlerësimit për vitet 2021 dhe 2022; Raporti i vijueshmërisë për vitin 2021 dhe 2022; Përgjigjja në kërkesë, me nr. ref. 07/1-01/087, i dt.

22.06.2021, së bashku me kërkesën e paditësit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vërtetim punësimi, i dt. 15.04.2021, lëshuar nga e paditura; Vërtetimi mbi ditët e punës, për periudhën kohore nga data 14.11.2018, 2019, 2020 e deri më dt. 31.05.2021, në emër të paditësit; Lista e pagave, në emër të paditësit, lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës; Formulari i vlerësimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më dt. 31.12.2020; Formulari i vlerësimit, për periudhën kohore nga data 23.07.2018 deri më dt. 01.01.2019; Formulari i vlerësimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri më dt. 31.12.2019.

Gjykata, analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar në ligj, ashtu që gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit, duke e detyruar të paditurën që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, t'ia paguajë paditësit shumën prej 3,662.75 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 30.07.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

Gjykata nga provat në shkresat e lëndës ka vërtetuar faktin se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 01.02.2012 (Vërtetimi nr.ref.04/01-06/SRR/0374/2021, dt. 15.04.2021), për periudhën 2021 dhe 2022, është vlerësuar me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm (Formulari i vlerësimit të performancave për këto 2 vite).

Nga Lista e pagave për muajin dhjetor 2018, 2019 dhe 2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi në dhjetor të vitit 2018 ka marrë pagë bruto 586.98 euro, në dhjetor të vitit 2019 ka marrë pagë bruto 836.71 euro dhe në dhjetor të vitit 2020 ka marrë pagë bruto në lartësi prej 696.98 euro, kurse nga pasqyra e Ministrisë së Financave, Departamenti i Thesarit, paditësi për vitin 2021 ka marrur pagë në lartësi prej 696.06€ dhe në vitin 2022 ka marrur pagë në lartësi prej 846.03€, që gjithsej kapin shumën prej 3,662.75 euro

Nga Vërtetimi mbi ditët e punës, për periudhën kohore nga data 14.11.2018, 2019, 2020 e deri më dt. 31.05.2021, në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi gjatë vitit 2018 ka qenë i pranishëm në punë 31 ditë, gjatë vitit 2019 ka qenë i pranishëm 239 ditë, gjatë vitit 2020 ka qenë i pranishëm 241 ditë, gjatë vitit 2021 ka qenë i pranishëm 101 ditë, gjithsej 612 ditë pune.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, gjykata i mori të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, si vërtetimin, formularin dhe listën e pagës, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror, këtu vetë e paditura.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, që përcakton se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se *“Marrëdhënia e*

punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*; pika 2 e këtij se *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj t’ia paguajë pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për shujtë ditore, për periudhën kohore 15.11.2018-31.12.2022, për 1018 ditë pune, t’ia paguajë paditësit shumën prej 2,036.0 euro, e llogaritur nga 2.00 euro në ditë, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 30.07.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, pasi gjeti se paditësit nuk i takon kompensimi i shujtave ditore, duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 1 të UA 02/18, që përcakton se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, e në lidhje me nenin 47, paragrafi 4 të Ligjit për Policinë, që përcakton se *“Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”*. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për shujtë ditore duhet të jetë shprehimisht i përcaktuar që të mund të vie në shprehje zbatimi i kësaj dispozite, ndërsa në rastin konkret meqë nuk ekziston ky përcaktim në legjislacionin në fuqi, e as në aktet nënligjore, kjo dispozitë mbetet e karakterit deklarativ, por nuk mund të ketë fuqi detyruese për palët nënshkruese.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë, në shumë prej 104.00 euro, pagesës së taksës gjyqësore për padi, në shumë prej 60.00 Euro, si dhe përfaqësimit në një seancë gjyqësore, në shumë prej 135.00 euro.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 150 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:171412
Datë: 25.01.2023
Numri i dokumentit: 03901250

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:171412, 23.01.2023

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.